



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odrejenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 3173 Më 08.10.2024
Br. prot. _____ Dt. _____
RAHOVEC - ORAHOVAC




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipal Rahovec

Drejtorija për Mbrojtje dhe Shpëtim

RAPORT NËNTË MUJOR I PUNËS

JANAR-SHTATOR 2024



Në kuadër të kompetencave dhe detyrave të drejtorisë, për periudhën janar-shtator 2024, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka realizuar detyrat e saj konform planit të punës për vitin 2023. Synimet e drejtorisë për punë efikase, përgjigje në kërkesat e qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë, bashkëpunim me akterët relevantë për mbrojtje të jetës dhe pronës, intervenim i shpejtë dhe profesional, përmbyllin sukseshëm punën gjashtë mujore të DMSH dhe NJPZSH.

- Gjatë periudhës janar-shtator, janë inspektuar lumenjtë, përrockat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e Komunës, inspektimi i tillë specifikisht në pikat kyçe ku situatë shihet më e rënduar bëhet disa herë në vit në mënyrë që të eliminohet rreziku për vërshime. Pas incizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse trajtim në ato vende ku ka pasur nevojë për ndërhyrje.

- Kemi bërë Inspektimin e rregullt të objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve.

Është kryer servisimi i parë për vitin 2024 i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte: Në objektet e Komunës së Rahovecit dhe zyreve të administratës publike në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF-të, Shtëpitë e Kulturës, muzetë dhe në palestrën e sporteve.

Inspektori për parandalim ka pasur 7 verifikime për dhënien e pëlqimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 11 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura.

▪ Në këtë nëntë mujor, janë hartuar dy dokumente të rëndësishme:

- Dokumenti mbi rreziqet dhe masat e sigurisë për muajt Korrik dhe Gusht, në të cilën periudhë rreziku për zjarre është tejet i madh si pasojë e temperaturave të larta.
- Dokumenti për Ngritjen e Gatishmërisë Emergjente për muajt Korrik dhe Gusht për vitin 2024, me të dhënat e dala nga ky dokument synojmë reagim të shpejtë të NJPZSH-së në mbrojtje të pronës dhe jetës dhe minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen.

- ▶ Është formuar grupi punës për hartimin e Planit Operativ Emergjent, në grupin punës janë të përfshirë të gjithë akterët të cilët në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, mund të kontribuojnë për ti ndihmuar qytetarët dhe minimizuar dëmet që mund të na shkaktohen.


Muajt korrik dhe gusht, u karakterizua më shumë zjarre, kryesisht zjarre të vogla fushore të cilat u lokalizuan dhe u shuan me kohë, falë punës së zjarfikësve nuk kemi pësuar dëme të mëdha në natyrë.

Ekipi i zjarrfikësve gjatë nëntë mujorit të vitit 2024, ka marrë gjithsej 272 kërkesa për intervenime, të ndara në kategori i gjeni në tabelarin e paraqitur më poshtë:

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.ijera janar-dhjetor 2024

2024	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr.i teknike	Nr.i shërbimeve	Nr.i aksidente	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar		Të vdekur		Gjithsej
								zj.	qyt.	zj.	qyt.	
Janar	5	0	1	2	1	0	0	0	0	0	0	5
Shkurt	29	24	2	0	1	0	2	0	0	0	0	29
Mars	13	11	0	2	0	0	0	0	0	0	0	13
Prill	7	3	0	1	1	2	0	0	0	0	0	7
Maj	11	3	3	5	0	0	0	0	0	0	0	11
Qershor	19	10	2	5	0	1	0	0	0	0	0	18
Korrik	79	72	0	2	3	0	2	0	0	0	0	79
Gusht	80	77	0	2	1	0	0	0	0	0	0	80
Shtator	30	25	1	3	1	0	1	0	0	0	0	30

Më 4 Maj 2024, me një aktivitet simbolik shënuam Ditën Ndërkombëtare të Zjarfikësve.



Drejtorë e Drejtorisë për
Mbrojtje dhe Shpëtim
Besmirë Bytyçi



Rahovec
07/10/2024